

Të nderuar kolegë deputetë,

Të më ndiej kolegja, por unë nuk e falënderoj dot ministren. Të më ndiesh, por nuk e kam kuptuar që roli im si deputet është të falënderoj qeverinë! Roli im si deputet, sipas Kushtetutës, është të kontrolloj qeverinë, t'i kërkoj llogari. Edhe për këtë të dytën të kërkoj falje, që duhet t'i kërkoj llogari ministres! Do të votoj kundër, sepse nuk mund të pajtohem me absurditetin e radhës, që ne duhet të marrim borxh për të shlyer borxhin. Borxhi i ri jo vetëm që nuk e shlyen borxhin e vjetër, por e shton atë. Kushtetuta i ka dhënë këtij parlamenti, të nderuar kolegë deputetë, të drejtën për t'i shqyrtuar këto akte, për të qenë një institucion i përgjegjshëm përballë qeverisë, për të frenuar dhe kontrolluar qeverinë, jo thjesht për të votuar atë që kërkon qeveria, por të diskutojë dhe vendosë, parlamenti, qoftë për nivelin e borxhit që merret, qoftë edhe për prioritetet e përdorimit të këtij borxhi. Këto borxhe nuk janë detyrime të qeverisë, të nderuar kolegë, këto borxhe janë detyrimet e shqiptarëve, janë detyrimet tona sot dhe të fëmijëve tanë nesër. Këto borxhe do të paguhen nga shqiptarët.

Ajo që ndodhi në Greqi vite më parë ka pasoja edhe sot dhe duhet të na bëjë të mendojmë qartë, se cilat janë rrugët dhe përparësitë tona. Është imediate që t'u japim përgjigje problemeve që kemi me financat publike. Si do të zgjidhet deficitin buxhetor? Si do të zgjidhet borxhi publik, i cili ka zënë 90% të prodhimit të brendshëm bruto? Ka qenë një ligj i miratuar nga ky Kuvend, bazuar në praktikën më të mira dhe në Marrëveshjen e Mastroitit, që borxhi publik nuk duhet të kalojë nivelin prej 60% të prodhimit të brendshëm bruto, për një menaxhim të drejtë të financave publike, por është hequr, për të arritur në këto nivele të borxhit, që është një kosto jashtëzakonisht e madhe për ekonominë dhe për të gjithë shqiptarët. Në këto nivele, të nderuar kolegë deputetë, asnjë borxh i brendshëm apo i jashtëm nuk mund të jetë efektiv. Eurobondi është një instrument financiar, kështu që sa më e madhe të jetë shuma, aq më i madh është edhe risku, sepse është borxh i huaj që ka rrezik më të lartë sesa ai i brendshmi, sepse paguhet me valutë dhe kostoja e borxhit rritet edhe nga ndryshimet e kurseve të këmbimit, që nuk janë në dorën tonë. Ka shumë rëndësi edhe pse merret borxhi, ku do të shkojnë paratë dhe me sa efektivitet përdoren ato, nëse përdoren për investime apo për shpenzime, për investime që sjellin zhvillim ekonomik apo shpenzime të cilat kënaqin interesat e caktuara. Por edhe nëse mundet të përdoret për investime të mira, në nivelin e borxhit që kemi ne, 90%, efektiviteti i këtij borxhi do të ishte pothuajse zero. Përdorimi i eurobondit është orientuar për konsum, kështu që dhe efektet ekonomike do t'i ketë të dobëta.

Për fatin e keq, qeveria e ka bazuar suksesin e saj afatshkurtër në rrënimin e financave publike për një periudhë afatgjatë. Kjo lexohet qartë edhe në buxhetin e vitit 2022, i cili bazohet në rritjen e borxhit publik, prandaj do të votoj kundër këtij eurobondi. Më lejoni, të nderuar kolegë deputetë, t'ju bëj një thirrje majtas dhe djathtas, qeveritarë apo opozitarë; të hapim sytë për të parë se çfarë po ndodh rreth nesh, në rajonin e Ballkanit. Nëse skenarët e përgatitur të konflikteve do të ndodhin vërtet, do të ketë pasoja të pakthyeshme për interesin tonë kombëtar. Ka paralajmërime për mundësi konfliktesh në Ballkan të iniciuara nga Serbia, prezente sot në Bosnjë, në Kosovë apo në Malin e Zi. Ekspertë të çështjeve ballkanike nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Europa, po flasin me shqetësim çdo ditë për një skenar të përgatitur në Moskë dhe të mbështetur nga Serbia, të instrumentalizuar nga Republika Serbska në Bosnjë- Hercegovinë për të rifilluar një konflikt të dytë mbas atij të '90-s. Prezenca e Shërbimeve Inteligjente Ruse në Nish, prezenca ushtarake dhe stërvitjet e përbashkëta ruso-serbe në Republika Serbska, tregojnë qartësisht se po përgatiten skenarë të një

konflikti të mundshëm. Shpenzimet ushtarake të Serbisë janë të jashtëzakonshme. Mbështetja me mjete luftarake jombrojtëse, por sulmuese, nga ana e Ruisë ndaj Serbisë, duhet të jetë një alarm i fortë, por për fatin e keq, i vetmi vend në Ballkan që ka reaguar deri më sot është Kroacia. Media ruse është prezente në të gjithë Ballkanin dhe ka gjetur gojëtarë dhe mbështetës, duke kërkuar që të harrohet historia e Serbisë, të asaj që ata kanë bërë në rajonin e Ballkanit, të viktimave që kanë krijuar, duke e shndërruar në marrëdhënie të re që duhet të kemi, të bashkëpunimit, për të lënë mënjanë historinë dhe për të ndërtuar në thonjëza një "histori të re", por me projekte që janë iniciuar prej kohësh, pikërisht në Beograd. Po ashtu, përfaqësues të parlamenti britanik sot ngrenë shqetësimin për një konflikt të mundshëm në Ballkan. CNN-i, rrjeti më prestigjioz i medias, ka thënë se shteti ballkanik i Bosnjë-Hercegovinës është në prag të asaj që analistët paralajmërojnë se është kriza e tij më serioze, që nga fundi i luftës në Bosnjë në vitin 1995.

Përfaqësuesi i lartë i komunitetit ndërkombëtar në Bosnjë, Christian Schmidt, paralajmëroi në fillim të kësaj jave se marrëveshja e paqes e ndërmjetësuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e nënshkruar në fund të luftës, rrezikon të shembet, nëse nuk ndërmerren veprime të menjëhershme energjike. Dodik, udhëheqësi serb i Presidencës së Bosnjës, ka kërcënuar se do të shkëputet nga pjesa tjetër e vendit. "Kjo është e barabartë me shkëputjen e pashpallur të Bosnjës", deklaroi Schmidt. Këshilli i Sigurimit ka marrë në diskutim këtë çështje. Po këtë javë, u mbledhën për të riautorizuar misionet e forcës paqeruajtëse të udhëhequr nga BE-ja, EUFOR-i, në Bosnje. Në një vend ku ndarjet etnike midis serbëve, boshnjakëve dhe kroatëve çuan në kryerjen e krimeve të luftës në historinë e fundit, ky nivel tensioni që po zhvillohet kthehet në një rrezik real. Gjithashtu, sipas CNN-it, nuk ka dyshim se kjo është kriza më e rrezikshme që nga viti 1995. Një mik i shqiptarëve, analist në SHBA, Janush Bugajaki, po ashtu, thotë: "Fokusi i politikave të jashtme të administratës Biden është kundërvënia ndaj Kinës, por Rusia po përgatit një konflikt në mes të Europës". Në fakt, nxitja e paparashikueshmërisë dhe paqëndrueshmërisë janë dy strategjitë kryesore të Moskës për të minuar Perëndimin. Ballkani Perëndimor mbetet objektivi kryesor për mundësinë e fuqizimit të Moskës. Mosmarrëveshja e fundit për njohjen e targave në kufirin Kosovë-Serbi duket si një provë për përballje më serioze. Zyrtarët rusë po nxisin qeverinë Vuçiç që ta transformojë Serbinë në fuqinë dominuese të Ballkanit Perëndimor dhe, kështu, të shtojnë shanset e Ruisë ndaj Uashingtonit dhe Brukselit. Në shtator Beogradi organizoi bllokimin përgjatë kufirit me Kosovën dhe, pasi vendosi trupat e tij në gatishmëri, kërcënoi me ndërhyrje ushtarake. Ambasadori rus shoqëroi ministrin e Mbrojtjes të Serbisë Stefanoviç gjatë inspektimit të njërive ushtarake serbe. Terreni propagandistik për konflikt është, gjithashtu, duke u përgatitur. Beogradi dhe Moska e akuzojnë qeverinë e Kosovës se po kërcënon ekzistencën e minoritetit serb. Gjatë ndërmarrjeve të tilla në Ukrainë dhe Gjeorgji, Kremli vazhdimisht ka përdorur pretendime të tilla në lidhje me popullsinë ruse atje. Tani Rusia po i mëson sivëllait të saj Serbisë metodologjinë e dominimit rajonal dhe të copëtimit territorial. Sipas një prej skenarëve, operativët e inteligjencës serbe dhe ruse mund të provokojnë konfrontime ndëretnike brenda Kosovës. Po ç' duhet të bëjmë ne?!

Së pari, të kuptojmë, të dashur miq e kolegë, se ndarjet në Ballkan nuk janë thjesht ekonomike. Nuk kanë vuajtur as ish-Jugosllavia, as Ballkani nga ndarjet ekonomike dhe nuk zgjidhen thjesht duke parë vetëm aspektin ekonomik. Ato janë të thella, historike, etnikofetare, dominancë dhe mbështetjeje gjeopolitike.

Së dyti, shqiptarët kanë pasur avantazhin e mbështetjes së SHBA-ve, BE-së dhe NATO-s, të cilat i kemi edhe sot, por si edhe dobësinë e Ruisë dhe Kinës në fillim të viteve 90 dhe fillimin e shekullit. Duket që balancat kanë ndryshuar, duhet të hapim sytë dhe të gjykojmë të gjithë së bashku, pa dallim politik për interesin tonë kombëtar. Çfarë duhet të bëjmë ne?! Së pari, kjo çështje duhet adresuar seriozisht dhe urgjentisht nga qeveria shqiptare, nga parlamenti shqiptar në NATO. Së dyti, parlamenti shqiptar

duhet të nxjerrë një rezolutë, duke dënua krimet e Serbisë dhe të gjithë skenarët destabilizues të Serbisë.

Së treti, parlamenti me delegacionet ndërparlamentare dhe Asamblatë Parlamentare duhet ta ngrenë patjetër këtë çështje në shërbim të interesave kombëtare dhe parandalimit të një konflikti të mundshëm.

Së katërti, është i nevojshëm distancimi i menjëhershëm i të gjithë klasës politike shqiptare me atakimin e klasës politike dhe drejtuesve politikë të Kosovës. Është e domosdoshme që ne të kemi ide të përbashkëta, gjuhë të përbashkët, veprime të përbashkëta dhe të konsultuara me partnerët tanë europianë dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Faleminderit!